



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional  
“Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr Klejd Këlliçi

2. Dr. Dorianë Pano

Janar/2021

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Master Profesional në “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim Publik
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 633, datë 05.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10/2
18	Numri i studentëve:	24
19	Komente / të tjera:	-


## PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës

Vizita e kryer pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës shërbeu për të mbledhur informacione rreth programit Master Profesional në “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik”, që ofrohet nga Departamenti i Administrimit Publik. GVJ zhvilloi vizitën në institucion në frymën e pozitivitetit e ndarjes së eksperiencave mes GVJ dhe anëtarëve të departamentit. Përgjithsisht programi që administrohet nga ky departament është në koherencë me logjikën sipas të cilës është ndërtuar departamenti. Burimet njerëzore dhe ekspertiza që ka në departament na bëjnë të kuptojmë se ky program është ndërtuar duke patur parasysh resurset e brendshme por dhe ato të jashtme që disponohen nga Universiteti apo që gjenden në tregun e punës. Universiteti pretendon se ka lidhje të forta territoriale e insitucionale me qarkun dhe qytetin e Durrësit. Për këtë arsye, ky program studimi mendohet se i vlen jo vetëm studentëve por edhe funksionarëve lokalë që duan e kërkojnë formim të vazhdueshëm. Pedagogët mendojnë që ky program është një prej pikave të forta në ofertën akademike që departamenti administron pasi bën edhe lidhjen logjike të vijimësisë me programin Bachelor. Përveç anës akademike, pikë e fortë e programit është mbështja nga zyrat ndihmëse të administratës së Universitetit. Zyra si ajo e projekteve, e sigurimit të brendshëm të cilësisë apo dhe ajo e karrierës, ofrojnë një mbështetje të madhe për anëtarët e departamentit apo dhe studentetët. Vihet re një lloj integrimi mes anës akademike dhe asaj burokratike që tregon një efëncë relativisht të kënaqshme në menaxhimin e programeve e aktiviteteve akademike.


Ky program studimi dhe është i ndarë në dy semestra. Në semestrin e parë zhvillohen pjesa më e madhe lëndëve me karakter teorik, ndërsa në të dytin zhvillohen si lëndë me karakter teorik po kështu dhe praktika dhe provimi final. Ky program është një prej programeve më të rëndësishme të administruara nga DAP e lidhet ngushtësisht me natyrën e këtij të fundit.

Pikat më të forta të këtij programi lidhen kryesisht me specializimin dhe kompetencën e DAP në fushën e administrimit publik si dhe me lidhjet që Universitetin ofron e ka me partnerët lokalë e kombëtarë që sigurojnë mbarëvajtjen e praktikave profesionale.



### **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Puna e grupit vlerësues nisi me shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni përmes platformës së ASCAL. Pas vlerësimit paraprak u bë e mundur vizita në Universitetin 'A. Moisiu', pranë Departamentit të Administrimit, vizitë në të cilën u panë nga afër problematikat e programit si dhe u mor në shqyrtim dokumentacioni suplementar i cili u vu në dispozicion nga njësi bazë dhe administrate e universitetit. Vizita u zhvillua në Durrës në datat 5-6 tetor 2020. GVJ kishte për detyrë të vlerësonte Programin e studimit Master Profesional në "Politika dhe Administrim", me profil "Administrim Publik". Gjatë vizitës së realizuar sipas agjendës së përgatitur bashkë me ASCAL, u mor kontakt me persona komponentë të ndryshëm të Departamentit të Administrimit, nisur nga drejtuesi i tij dhe Dekani i Fakultetit. Pas shpjegimeve e prezantimit të rastit, u zhvilluan biseda me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm që kishte realizuar procesin e vlerësimit i cili dha shpjegimet e rastit. Më pas u kryen takime me komponentë të tjerë të trupës akademike dhe studentët. Në datën 6 u vijua me takimet e tjera të parashikuara në agjendë si me, Njësinë Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Projekteve etj. Përgjithsisht ky proces u zhvillua në mënyrë korrekte. GVJ pati akses të plotë dhe pse procesi u zhvillua nën masat restriktive anti Covid 19. E gjithë vizita u krye në një frymë konstruktive dhe bashkëpunuese. Autoritetet, stafi akademik e studentët u treguan të gatshëm përgjatë gjithë vizitës të ndanin mendimet e opinionet e tyre në lidhje me programin por dhe me Universitetin në përgjithësi.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik”

### I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Vlerësimi është pozitiv. Programet jo vetëm që nuk bien ndesh por i shërbejnë interesave kombëtare dhe atyre lokalë në lidhje me formimin e kandidatëve të administratës publike. [Aneksi 1, Standardi I.2]			
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi ka si qëllim formimin e figurave profesionale në fushën e administrimit publik. Pretendohet se këto figura profesionale do të jenë një gjeneratë e re administratorësh të cilët përgatiten për sfidat e reja të shtetit shqiptar sikurse integrimi evropian dhe bashkëverpimi rajonal. [Aneksi 1, ‘Mendimi i Dekanit’]			
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni i U. A. Moisiu lidhet fort me territorin e qarkut të Durrësit. Vërehet nga kjo anë një vokacion i fortë për tu identifikuar dhe zhvilluar krahas territorit por edhe më gjerë duke qenë se është një ndër të paktët programe në nivel kombëtar që ofron formim specifik në administrimin publik. [Minutat e takimit në UAMD; Aneksi 59,59.1]			
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi ka si qëllim të shërbejë e të mundësojë formimin e figurave profesionale polivalente në fushën e administrimit. Të diplomuarit e këtij programi studimi janë të pajisur me njohuritë e duhura profesionale, për të sjellë në tregun e punës një grup të përgatitur administratorësh që do të ndikojnë në administrimin e kontekstit ku ndodhet UAMD dhe më gjerë. [Aneksi 1, ‘Mendimi i Dekanit’]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi I.2</b>				
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Institucioni ka një plan strategjik zhvillimi për periudhën 2016-2020, pjesë e të cilit është dhe program [Aneksi 6]. Programet e studimit mbështeten dhe reflektojnë strategjinë e institucionit në aspektet formale dhe materiale.			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e	Drejtimet prioritare akademike përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e			

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

5

institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	institucionit, si dhe në planin strategjik të FShPJ. Ndonëse në planin strategjik nuk ka element specifikë të programit, drejtimet prioritare të FShPJ janë ato të përmirësimit dhe përditësimit të metodologjisë dhe kërkimit shkencor që lidhet detyrimisht me programet e studimit që ofrohen [Aneksin 10, Prioritetet].			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Misioni i Departamentit që ofron programi është qartë. Fushat dhe ekspertiza që programi ofron përputhen me fushat akademike dhe drejtimet që institucioni ka [Aneksin 9, f.9]			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Qëllimi i programit është integrimi i strategjive kombëtare të zhvillimit, atyre të institucionit dhe burimeve të brendshme. Përgjithësisht këto përkojnë dhe programi është rezultat i sa më sipër [Aneksin 10, Aneksi 9, f.4-5].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Objektivat objektivat e programit të studimit MPAP janë të qarta. Ato përputhen me profilin e masterit dhe me kërkesat e tregut të punës. Në analizën dhe bisedën me anëtarët e departamentit, administrata publike perceptohet si një treg pune relativisht i madh dhe jo shumë elastik. Pavarësisht kësaj drejtuesit e institucionit pretendojnë që sfidat me të cilat përballlet administrata publike janë të atilla sa që kërkojnë formim të vazhdueshëm. Në këtë kuptim, ato e shohin programin si një program fleksibël që mund të ofrohet kujtdo anëtar të administratës publike, pavarësisht profilin. [Aneksi 9, f.4-5; Aneksi 21]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Institucioni përdor disa forma në analizën e tregut të punës dhe pse analiza për këtë lloj programi mbetet kërkesa për punë që vjen nga institucionet publike. Këto reflektohen në pritshmëritë e studentëve mbi programin [Aneksi 31 dhe 32], në nëshkrimin e marrëveshjeve specifike me aktorë publikë që përshtaten me profilin e masterit [Aneksin 59 dhe 59.1] dhe më specifikisht në analizën e tregut të punës [Aneksi 73 dhe 73.1].

<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formuese garantojnë përfitim të dijeve dhe i përgjigjen në mos nevojave të tregut të punës, kritereve që punëdhënësit kërkojnë për pozicione specifike, në kuadrin e administratës publike [Aneksin 73.1] dhe opinionet e studentëve për MPPA [Aneksin 31 dhe Minutat e takimit].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të lehtësohen procedurat e transferimit të krediteve për mobilitetin e studentëve. Përsa i përket tregut ndërkombëtar të punës, kompetencat që ofron insititucioni janë lehtësisht të përdorshme dhe pse programi është ndërtuar për tju përgjigjur kryesisht tregut të brendshëm [Aneksi 76 ku përcaktohen kriteret e përgjithshme mbi të cilat realizohet transferimi].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programet e studimit janë hartuar jo vetëm si pasojë e formimit dhe objektivave të FSHPJ dhe DAP, por duke patur parasysh dhe kriteret e organizimit të programeve të ngjashëm në praktikatat më të mira evropiane [Aneksin 9, Analiza vjetore DAP].</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Departamenti i Administratës Publike është shumë i ndjeshëm në raport me praktikatat profesionale. Ato kryhen konform kompetencave që ofron plani i studimit dhe në bazë të inistitucioneve ku mendohet se do të punojnë studentët. Për këtë janë nënshkruar një sërë marrëveshjes me subjekte që përshtaten me njohuritë e marra në master [Aneksin 59-61].</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Në programin MPPA nuk ka lëndë në gjuhë të huaj. Në bisedën me pedagogët u përmend se në universitet ofrohen në anglisht që shërbejnë kryesisht për nevojat e studentëve që vijnë përmes programit Erasmus. Në nivel masteri mund të ofroreshin lëndë të tilla [Minutat e takimit]. Nuk parashikohen në të ardhmen lëndë të tilla, por nuk përjashtohet ky eventualitet, me rritjen e kërkesës nga studentë të huaj që mund të kryejnë studime Erasmus në UAMD. Po kështu është nënshkruar një marrëveshje mes Universitetit të Nicës, Sophia Antipolis, për një program të dyfishtë studimi që do të implikojë dhe përdorimin e gjuhës së huaj në program [Minutat e takimit].</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Struktura e MPPA lejon disa lëndë me zgjedhje. Këto mund të shërbejnë për të ndërtuar një profil të caktuar. Këto lëndë janë kryesisht të profilit të shkencave politike e janë konceptuar si plotësuese të atyre bërthamë të masterit të profilit ekonomik [Aneksi 27, Kurrikulat].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

7

**Standardi I.4**

**Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	DAP ka të gjitha kapacitetet, qoftë si departament qoftë në ndërveprim me departamente të tjera të Universitetit, për të përballuar me sukses objektivat akademikë që programi ofron. DAP është një prej departamenteve historikë dhe më të konsoliduar në UAMD. Një ekesperiencë e tillë vlen dhe për cilësinë dhe besueshmërinë e programeve që ai ofron [Aneksi 30].			
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasi fikimit/kodi fikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Përputhen plotësisht. Pedagogët kanë formim juridik, ekonomik dhe në lëmin e shkencave politike. Programi arrin të ndërthurë këto kapacitete të cilat plotësohen dhe nga resurse të tjera jashtë Departamentit në nivel Fakulteti dhe Universiteti [Aneksi 111,111.1 dhe 111.2].			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasi fikimit/kodi fikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Njësia bazë e orienton dhe punën kërkimore shkencore në përputhje me programet që ofron. Për këtë organizohet dhe të paktën një konferencë shkencore në vit e cila hulumton problemet e çështjet që kanë të bëjnë me administratën publike. Për këtë vlen të përmendet analiza e punës shkencore të vetë departamentit [Aneksi 45], natyra e konferencave të zhvilluara [Aneksi 113] apo projektet e zhvilluara në rang departamenti [Aneksi 130].			
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi i studimit në proces akreditimi ofrohet vetëm nga UAMD dhe për këtë arsye ky kriter nuk aplikohet për këtë program.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi I.5**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Adresa: “Rruga e Durrësit”



Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

8



<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësi ve e personelit, marrjes së përgjegjësi ve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Organizimi i punës bëhet mes njësisë bazë për anën akademike dhe zyrave ndihmëse të administratës së universitetit. Analiza e punës kryhet nga njësia për sigurimin e cilësisë. DAP është përgjegjës për anën akademike, organizimin e kërkimit shkencor. Analiza e punës bëhet përmes dy komponentëve, analizës së brendëshme të DAP [Aneksi 74] dhe NjSBC [Aneksi 133].			
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Marrëveshjet ndahen në dy lloje, ato specifike për planin e studimit dhe ato më të gjera që nënshkruhen nga Universiteti. Të parat i shërbejnë specifikuisht planit të studimit kryesisht në fushën e praktikave [Aneksi 59. 59.1], të dytat ndërkombëtarizimit dhe formimit të mëtejshëm të personelit [Aneksi 63, 64 Mobilitete Erasmus Aneksi 40 Marrëveshje Erasmus]. Këto marrëveshje shërbejnë për realizimin e objektivave të institucionit dhe DAP në veçanti, duke marrë parasysh dhe natyrën e masterit profesional.			
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Institucioni ka marrëveshje specifike bashkëpunimi dhe të përgjithshme. Ato specifike lidhen me kapacitetet praktike dhe formuese të programit e përshijnë kryesisht insitucione publike lokale e kombëtare (Bashkia Durrës, Autoriteti Portual etj). Ato të përgjithshme janë përgjithsisht të rrafshit akademik e mundësojnë ofrimin e aktiviteteve akademike në funksion të planit të studimit (Universitete të ndryshme në rajon) [Aneksin 59. 59.1].			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Praktikat mbikqyren si nga anëtarë të departamentit si nga institucionet pritëse. Ato zhvillohen në insitucione të përshtatshme me objektivat formuese të programeve të studimit master [Aneksin 67]. Mbikqyrja kryhet nga insitucioni dërgues dhe ai pritës. DAP ka hartuar dhe një paketë udhëzimesh mbi kryerjen e praktikës [Aneksin 68].			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Trajnimet kryesisht ofrohen nga zyra e karrierës dhe kanë të bëjnë me shumë me kapacitetet praktike që studentët duhet të kenë në raport me tregun e punës. Po kështu ofrohen dhe leksione apo prezantime specifike nga aktorë të jashtëm insitucionalë ose akademikë që përputhen me fushën e studimit të programit MPPA [Minutat e takimit me zyrën e Karrierës si dhe Aneksi 41, neni 7]			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nuk ka një analizë të tillë por mund të nënkuptohet nga bërja/zhvillimi i praktikave dhe materializimi i këtyre marrëveshjeve në praktikë sikurse raportohet me konferencat e ndryshme qe DAP ka zhvilluar me partnerë të jashtëm sikurse ISP, KAS etj. Kjo analizë kuptohet në mënyrë të tërthortë përmes raportit të vlerësimit të FShPJ [Aneksin 30, f.10-12 dhe Aneksi 9, Analiza vjetore DAP].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Plot përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MPPA është organizuar sipas legjislacionit në fuqi kriterëve evropiane mbi kreditet formuese (ECTS). Programi MPPA është ndarë në lëndë të cilat kanë nga 6 kredite ECTS. Kjo ndarje ofron fleksibilitet në transferimin e krediteve dhe mobilitetin e studentëve [Aneksi 21].
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.	Studentët në master janë dy kategori, ato që vijnë nga cikli i studimeve bachelor i të njëjtës fushë ose atyre të ngjashme, dhe studentëve që regjistrohen rishtas dhe vijnë nga fusha të tjera formimi. Po kështu në MPPA regjistrohen dhe studentë të cilët punojnë në administratën publike. Shprehitë që ky program masteri ofron shërbejnë në punën e aktivitetin e tyre të përditshëm [Aneksin 21 dhe Aneksin 30].
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi MPPA synon të japë njohuri praktike dhe teorike mbi aspekte të përgjithshme e të veçanta të Administratës Publike. Një prej aspekteve që theksohet shumë është mundësimi i aplikimit në praktikë të metodave të kërkimit shkencor në praktikën e punës [Aneksi 30, f.10-12].
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Qëllimi i programit MPPA është të ofrojë njohuri e kompetenca të avancuara pa bërë thyrje të forta mes ciklit të parë të studimeve bachelor dhe atij Master. Në këtë kuptim lëndët janë të ndërtuara duke përdorur cilësimin 'e avancuar'. Njohuritë bazë të marra në ciklin e parë të studimeve i nënshtrohen një thellimi të mëtejshëm në fusha specifike si administrim apo financa publike etjer. Fusha e specializimit në studime është ajo në Administrim Publik [Aneksin 21].
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit në MPPA është ndërtuar konform legjislacionit në fuqi dhe përmbajnë të gjitha elementët e nevojshëm për një kurs të tillë. Programi ka 60 kredite, ai është ndarë në lëndë e module sipas udhëzimit 31 të MASH [Aneksin 29]. Në semestrin e parë ofrohen katër lëndë të formimit bazë dhe një me zgjedhje. Në semestrin e dytë, dy lëndë të detyrueshme, një me zgjedhje, praktika e më pas provimi i formimit.
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë	Lëndët e modulet ndahen në tre grupe: formim juridik, ekonomik dhe teoriko politik. Ato ndahen në lëndë teorike dhe praktika e përgatitja e

veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	mikrotezës. Po kështu kursi parashikon dhe disa lëndë të cilat duhet të merren nga student të cilët nuk kanë një formim paraprak në Administrim. Predominojnë lëndët e fushës së ekonomisë dhe administrimit publik (30 ETSC). Lëndët e formimit juridik e teoriko politik janë me zgjedhje (12 ETSC). Një ndarje e tillë është përshtatshme për Masterin ndonëse do të ishte e udhës që lënda E Drejtë Administrative të ishte e detyrueshme [Aneksin 24].			
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Programi në MPPA parashikon një ngarkesë prej 6 kreditesh për praktikën. Në bazë të dokumentacionit praktika zhvillohet në një institucion. Ajo ndiqet nga mentori i Universitetit dhe ai i institucionit. Më pas shoqërohet me dokumentacionin përkatës. Forma e mënyra e kryerjes së praktikës parashikohet nga <i>Rregullorja mbi miratimin e praktikës</i> , që i referohet akteve ligjore e nënligjore në fuqi [Aneksi 48, neni 1 dhe 48.1].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia bazë është Departamenti i Administrimit Publik. Kjo njësi funksionon në bazë të legjislacionit mbi Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit, Rregullores së Fakultetit dhe asaj të Departamentit [Aneksin 1,2,19 dhe 23].
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia bazë është Departamenti i Administrimit Publik. Ajo përmbush detyrimet ligjore e nën ligjore për organizimin e strukturës akademike. DAP ka në përbërje të saj pedagogë me gradën Prof.Dr, 2; Prof.Asoc. 5 e D. Shkencash, 11. Formimi i tyre profesional orientohet kah fushës së Administrimit Publik dhe Shkencave Politike [Aneksi 114 dhe RVB].
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të fuar.	Raportet janë të drejta përsa i përket shpërndarjes së lëndëve. Fushat e studimit të personelit akademik variojnë nga ato të shkencave politike, administrim, ekonomi, jurisprudencë [Aneksin 111,111.1, 111.2]. Të gjithë anëtarët e departamentit kanë formimin e duhur akademik për lëndët që zhvillojnë. Kjo vihet re dhe për pedagogët e jashtëm [Aneksin 114]. Njësia bazë ka stafin e nevojshëm për të përmbushur çdo detyrim ligjor që rrjedh nga ligji në fuqi. Në përbërje të saj janë 17 anëtarë me kohë të plotë, ndërkohë që sipas dokumentacionit, ka një listë prej 27 pedagogësh të jashtëm dhe 9 të fuar për programin në shqyrtim [Aneksin 114].
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel	Njësia kryesore angazhon resurset e brendëshme për monitorimin e praktikave. Në disa raste ngarkesa e praktikave është e zhdrejtë në raport

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

11

akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	me numrin e pedagogëve që i ndjekin ato. Drejtuesi i njësisë u shpreh që këto janë raste të rralla por të paktën sigurohet që praktika të ndiqet sa më mirë nga pedagogët dhe të këtë një raport sa më të afërt me studentët praktikantë [Minutat e takimit].			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi ka një kordinator i cili mbikqyr mbarëvajtjen e kursit dhe zhvillimin e programit [Aneksin 48, neni 17]. Personi i ngarkuar është dhe përgjegjës për mbarëvajtjen e praktikave mësimore apo implementimin e aktiviteteve që lidhen me kursin të cilin ai mbulon.			
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Çdo program sikurse dhe programi i studimit Master Profesional në Politika dhe Administrim me profil “Adminsitrim Publik” ka një kordinator. Roli i kordinatorit është ai i monitorimi të mbarëvajtjes së programit të studimit MPAP. Po kështu ai raporton tek drejtuesi i njësisë për problemet apo sugjerimet e mundëshme për përmirësimin e programit [Aneksin 48 neni 17].			
<b>Program studimiShkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë vepron në bazë të Statutit, Rregullores së FShPJ dhe të rregullores së brendëshme. E gjithë kjo mbështetet në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet e tjera nënligjore. Universiteti siguron të gjithë informacionin e nevojshëm që më pas i transmetohet dhe DAP për tu reflektuar në programet që ai administron [RVB dhe Aneksin 21, Aneksi 1 dhe 2].
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Kurrikula është e organizuar në lëndë të detyrueshme 4 dhe 1 me zgjedhje në semestrin I. Në të dytin ka 3 lëndë të detyrueshme nga të cilat 1 me zgjedhje e më pas praktika mësimore [Aneksin 27 dhe atë 21].
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Lëndët janë të ndara në kredite 6 për 1 lëndë duke marrë si bazë sistemin ETSC. Po kështu ndarja është ajo e vitit në dy semestra [Aneksin 27 dhe 21].
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e	Plani mësimor është i qartë. Në të përfshihen të gjithë komponentët e nevojshëm që parashikojnë ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin, vlerësimin e dijeve dhe përfundimin e studimeve. Rregullorja e MPAP parashikon qartë dhe me hollësi sa më sipër [Aneksin 21].

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

12

programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.									
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet mbi programin MPAP ofrohen nga rregullorja e cila qartëson kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe të ekuivalentimit [shih Aneksin 21]. Po kështu në dokumentacionin e paraqitur për procedurën e vlerësimit jepet dhe një dokument sqarues që orienton DAP në kryerjen e procedurave të ekuivalentimit dhe të transferimit të studentëve në këtë program [Aneksin 76 mbi Praktikat e transferimit].								
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet e studimit përmbajnë listën e lëndëve, përshkrimin dhe objektivat e në rastin konkret të programit të studimit MPAP. Përsa i përket syllabuseve është pak e paqartë si komunikohet përmbajtja e e tyre. Këto të fundit janë të detajuara dhe me gjasë i komunikohen vetë studentëve çdo fillim viti përmes faqes së internetit dhe pedagogut [mbi përmbajtjen e syllabuseve shih shembujt në Aneksin 103,104,105].								
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Çdo fillim viti propozohen dhe miratohen ndryshimet eventuale në program. Ndryshimet në program propozohen dhe hartohen nga DAP e më pas miratohen në Senat. Për procedurën shih [Aneksi 47, neni 32]. Procedura aktivizohet, nëse është e nevojshme çdo fillim viti.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit MPAP është strukturuar në dy semestra, me nga 30 kredite secili. Në të kombinohen lëndë teorike, lëndë me zgjedhje, praktika dhe punimi i diplomës. Masteri thekson më së shumti formimin me natyrë ekonomike të studentit. Lëndët teorike zenë peshën më të madhe në programin e studimit. Praktika dhe punimi i diplomës/provimit vlejné 12 kredite. Një ndarje e tillë ka kuptim për strukturën e organizimin e programit ndonëse masteri ka karakter profesional [Aneksin 27].
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive	Lëndët në disa raste kanë cilësimin 'e thelluar'. Mendohet që ato janë vijimësi e të programit të nivelit të parë bachelor. Në programin e studimit MPAP këto njohuri bazë thellohen më tej [Aneksin

dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	103,104,105].
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Lëndët janë të formimit juridik dhe ekonomik si dhe ato specifike të metodave të kërkimit. Ndër to futen dhe lëndë të shkencave politike sikurse Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Për nga natyra programi është i balancuar dhe arrin objektivat formuese [mbi përmbajtjen e lëndëve shih Aneksat 103,104,105].
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Në këtë program studimi master respektohet raporti mes praktikës dhe teorisë sidomos duke patur parasysh që kemi të bëjmë me një program të tipit Master Profesional. Për këtë arsye praktika zë peshë më të madhe në këtë program. Në anën tjetër për programe të tilla studimi në vende të tjera praktika zë peshë akoma dhe më të madhe në kurikulum. Në rastin shqiptar kjo ka të bëjë me mënyrën si janë hartuar rregulloret që rregullojnë praktikën në programet e studimit të tipit master profesional (nga biseda me studentët doli në pah se ata sugjerorin rritjen e peshës së praktikës në program [Minutat e takimit]. Praktika ka minimalisht 6 kredite, dhe pjesa e programit realizohet me mësim në auditor [Aneksi 27].
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Formimi praktik është një fraksion i programit prej 60 kreditesh. Në këtë master ze peshë më shumë formimi teorik se sa ai praktik. Aspekti pozitiv është se disa prej lëndëve kanë orientim të fortë praktik gjë që plotëson praktikën. Këto lëndë janë Drejtim Projekti apo Sjellje Organizative e Avancuar [Aneksi 27].
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Programet e lëndëve mbështen në kombinimin e literaturës dhe leksioneve të shkruara nga pedagogët. Literatura është e përshtatshme me atë që synohet dhe kërkohet të ofrohet nga program i studimit MPAP. [Minutat e takimit dhe Aneksat III.1, III.2, III.3].
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Synimi i programit të studimit të MPAP është qartë. Përmbajtja e programeve të lëndëve specifike përkon me objektivat e përgjithshme të programit. Lëndët garantojnë përfundimin e dijeve në fushat që lidhen me administrimin publik duke thelluar njohuritë e marra në ciklin e parë të studimeve bachelor si dhe duke i shtuar dhe plotësuar ato me dije e njohuri suplementare, të orientuara specifikisht mbi administrimin publik.
<b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Ky program studimi siguron aftësi dhe kompetenca profesionale në fushën e administrimit publik si për studentët që kalojnë nga programe studimi të ciklit të parë si dhe për ata studentë që janë pjesë e administratës publike. Gjatë bisedës me disa prej studentëve që punojnë në administratë publike, u tha se njohuritë e marra u kanë shërbyer në punën e tyre të përditshme. [Minutat e takimit].
<b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve	Tregu kryesor i punës për studentët e këtij programi mbetet administrata publike. UAMD ka shumë marrëveshje me institucionet lokale. Shumica e studentëve i zhvillon praktikën në këto institucione. Duke parë

në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	kohëzgjatjen e këtij programi, gjykojmë se ai i është përshtatur vazhdimisht kërkesave apo dinamikave që dalin nga marrëveshjet me Inistitucionet e ndryshme të A.Publike në raport me kriteret e organizmit e formimit [Aneksin 73 mbi Studimin e tregut të punës].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik angazhohet plotësisht në realizimin e programit të studimit. Departamenti i ka të gjitha resurset e duhura njerëzore për të mbuluar fushat e studimit. Raporti mes PAK dhe PAE është 17/28 plus 9 pedagogë të ftuar. Ndarja e ngarkesës respekton kriterin ku 70% e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 30% nga PAK [Aneksin 114].
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Si personeli i brendshëm dhe ai i jashtëm kanë nivelin e duhur të kualifikimit. Prof. Dr. 2; Prof.Asoc. 5 e D. Shkencash, 11. Po kështu personeli i jashtëm rekrutohet duke patur parasysh specifikisht kompetencat, fushën e studimit të të programit studimor të ciklit të dytë MPPA [Aneks I. Statuti UAMD, neni 45, pika 2,]. Personeli i jashtëm është rekrutuar duke pasur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi [Aneks 29.Udhëzim].
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Njësia bazë ofron programe studimi të cilat arrin ti mbulojë jo vetëm fizikisht por dhe cilësisht me personel të kualifikuar. Ajo mbështetet dhe në kompetenca paralele që ofrohen brenda Universitetit nga departamente të tjerë [Minutat e takimit].
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me aktorë publikë e privatë për zhvillimin e praktikave mësimore. Këto marrëveshje kanë parasysh disa kriteret si natyra e programit studimor dhe kapacitetet e personelit akademik. Personeli akademik ndjek praktikat e studentëve në insititucionet e sipërpërmendura. Pedagogët i ndjekin këto praktika nisur nga natyra e institucioneve dhe formimi akademik që ata kanë. Gjatë vizitës u përmend fakti se ka patur disa raste ku një pedagog ka ndjekur më shumë studentë se ç'parashikohet në një institucion. Kjo nuk kishte ardhur nga mungesa e personelit akademik të DAP por më shumë nga natyra e praktikës dhe e institucionit dhe formimi i përshtatshëm i pedagogut [Minutat e takimit].
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton	Nuk aplikohet për këtë program studimi.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

15

angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nuk ka një orientim të qartë që përmbush këtë pikë. Ky program studimi mbështetet në analizën e tregut të punës që kryhet nga njësia bazë, [Aneksi 73/73.1]. Në këtë raport përmenden intervistat me aktorët e interesuar, administratën publike të cilët japin mendimin e tyre për atë që ata si punëmarrës potencialë kërkojnë nga programet e studimit që UAMD ofron. Anketimi mbi tregun e punës përfshin dhe studentët. Për këtë janë intervistuar rreth 344 studentë të programit studimor të ciklit të parë bachelor.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Universiteti ka ndihmuar në krijimin e organizatës ALUMNI të UAMD. Me ndihmën e Universitetit kjo organizatë mban lidhjet me studentët. Një prej arsyeve të krijimit të organizatës Alumni është dhe marrja e mendimeve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe natyrës së programeve studimore që DAP ofron, [Aneksi 52].
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Nuk është e qartë nëse bashkëpunimi me faktorë të jashtëm, si institucionet që UAMD ka marrëveshje, ndikon në përditësimin dhe rifreskimin e kurrikulës, apo nëse ndërtohen programe specifike që vijnë si kërkesë e partnerëve të jashtëm. Përshtatja apo rifreskimi i kurrikulës më shumë diktohet nga pyetori dhe analiza që i bëhet atij në raport me mendimin e studentëve dhe inuteve që mund ti vijnë anëtarëve të departamentit. Një shembull i tillë jepet në Aneksin 74 si propozim për rifreskimin e kurrikulës. Ndryshimet mbështeteshin në disa kriteret: -kohëzgjatja nga ndryshimet pararendëse, 7 vjet -risitë e gjendura në programe të ngjashme jashtë vendit



	-orientimi i formimit në bazë të kërkesave të tregut. [Aneksi 74, Memo, f.11-12].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga analiza e dokumentacionit nuk del ndonjë orientim institucional për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Kur flitet për metoda inovative, diskutimi mbahet në nivel të përgjithshëm. Metodat e reja të mësimdhënies mbeten më shumë në rrafshin e qëllimeve institucionit se sa në aplikimin e tyre praktik.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Instrumenti më i rëndësishëm për monitorimin e aftësive mësimdhënëse mbetet pyetsori i cili zhvillohet çdo vit nga NjsBC. Një pjesë e këtij pyetsori merret dhe me cilësinë e msidhënies, [Aneksi 134]. Po kështu dhe në analizën e tregut të punës, merren mendimet e studentëve mbi cilësinë e programit të studimit Master.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Studentët agazhohen në vlerësimin periodik të studimeve në përgjithësi përmes pyetsorit, [Aneksi 134 dhe aneksi 73/73.1]. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar del se përgjithsisht, studentët janë të kënaqur me mësimdhënien. Për ankesat ka një dispozitë të veçantë në rregulloren e DAP. Ankesat trajtohen nga Dekani e më pas i kalohen departamentit për shqyrtim. Ky i fundit ngre një komision për verifikimin e tyre [Aneksi 48, neni 60].
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet bëhen publike. Ato që kanë të bëjnë me pedagogët i jepen personalisht atyre. Departamenti merr në shqyrtim rezultatet e bën analizën e tyre [shih Aneksi 133, Rregullorja e NjsBC, neni 6].
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të	Nga vizita në IAL dhe takimet me stafin akademik, konstatoam se realizohen pyetësore të studentëve të cilat vlerëson stafin akademik, si edhe vlersim nga drejtuesi i departamentit, por nuk u evidentua ndonjë rast promovimi i stafit nga rezultatet e vlerësimeve të mësipërme.

mësimdhënies.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies janë ato klasike për studimet në shkencë humane të leksioneve frontale. Në UAMD formati parashikon vetëm leksione prej tre orësh, pra jo seminare. Nëse ky mund të jetë problem për nivelin e studimeve të ciklit bachelor, patur parasysh numrin e madh të studentëve, nuk është problem për ciklin e studimeve të programeve master. Studentëve gjithashtu u kërkohen në bazë të lëndëve të realizojnë projekte të përbashkët e punë në grup [Aneksi 21, neni 17].
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Është e vështirë të kuptohet se si realizohet një kriter i tillë. Formalisht studentët përfshihen në shumë nivel organizmave të Universitetit. Funkcioni i tyre është konsultativ. Përmes pyetorit që zhvillohet çdo vit, vilen mendimet e studentëve, ndër të tjera dhe posaçërisht ai mbi aspektet e mësimdhënies. Në masën 98 % studentët janë të kënaqur me mësimdhënien [Aneksin 31]. Në RVB thuhet sugjerimet e studentëve kanë gjetur vend e janë reflektuar nga DAP në rishikimin e kurrikulës, [Aneksi 156, Standardi II.6], por nuk ka indikacione nëse sa më sipër ka prekur, metodat e mësimdhënies.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.	Institucioni mbështet pedagogun në procesin e mësimdhënies. Nuk ka orientime të qarta për përdorimin e metodave inovative. Struktura e mësimdhënies ndarë në leksione tre orëshe nuk ofron ndonjë fleksibilitet të madh për përdorimin e metodave inovative. Rëndom këto pritshmëri mbështeten në syllabus dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit në funksion të evolucionit të tregut të punës. Gjithsesi gjatë vizitës, ju mëshua faktit se Institucioni promovon shfrytëzimin e programeve dhe marrëveshjeve Erasmus, si ato të mësimdhënies apo dhe ato të formimit profesional [Aneksin 135, Analizë e DPMJ].
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik është mësues i kualifikuar në fushat e studimit të cilat prek ky program studimi. Metodat e konceptet që përdoren gjenden të përfshira në syllabus. Pedagogët mbulojnë më së shumti lëndë për të cilat kanë kompetenca të përfuara nga formimi i tyre akademik [Aneksi 111.1, 111.2, 111.3].
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar	Mendimet e studentëve reflektohen në pyetor i cili administrohet nga NjSBC, e me pas rezultatet e tij diskutohen në nivel departamenti. Nuk është e qartë nëse sugjerimet e studentëve merren parasysh për tu reflektuar më pas në ndryshimet e mundëshme që mund të pësojë

mendimet e sugjerimet e tyre.	programi i studimit. Përgjithsisht studentët janë të kënaqur me mësidhënien [shih Aneksin 31].			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Metodat e mënyrat si drejtohet mësimi mbeten në autonominë e pedagogut i cili orienton dhe organizon mësimin sipas kurrikulës dhe praktikave më të mira të institucionit. Në bazë të diskutimeve me pedagogët e sidomos në programin e studimit master, privilegohen diskutimet mbi temat të ndryshme që ofrohen në lëndët e programit. Ky kriter përmbushet plotësisht. [Minutat e takimit].			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Një prej elementëve që programi inkurajon është të menduarit kritik dhe aftësimi të studentit të veprojë me autonomi në zgjidhjen e problemeve me të cilat ata përballen. Për këtë ata gjejnë mbështetje nga mësimdhënësit. UAMD ka hartuar dhe një strukturë mentorimi përmes së cilës një student ndiqet nga një pedagog përgjatë gjithë karrierës së tij universitare [Aneksi 98, 2. Qëllimi].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Njësia bazë ndodhet në Kampusin e Ri të UAMD. Për mënyrën si është projektuar dhe realizuar ky kompleks, mendojmë se ky kriter përmbushet plotësisht.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Mësimdhënia zhvillohet në klasa me kapacitet prej 90 vetash dhe më të vogla, salla seminaresh me kapacitet përafërsisht prej 40 vetash. Klasat janë të pajisura me mjetet teknologjike si kompjuter e projektorë që bëjnë të mundur zhvillimin dhe realizimin e procesit mësimor. Kampusi është projektuar posaçërisht si strukturë universitare. Për pasojë dhe si infrastrukturë e përgjithshme dhe e veçantë, ajo përmbush nevojat për realizimin e procesit mësimor [Aneksin 121].
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Pranë UAMD ka një laborator IT dhe një ambient biblioteke. Ky i fundit është tejet i vogël për të përmbushur nevojat e studentëve. Po kështu njësia kryesore e bibliotekës gjendet në godinën e rektoratit, rruga Currila, Durrës, ndërsa pjesa dërrmuese e studentëve janë në Kampusin, UAMD Kënetë. Interneti ëireless është disponibël dhe i lirë për tu përdorur nga studentët. Gjatë vizitës nuk pamë një sallë të dedikuar për shfrytëzimin e pajisjeve kompjuterike. Gjithsesi IT është përdorur gjerësisht nga pedagogët për mësimdhënie, sidomos në fazat e lehtësimi të masave andikovid në maj të vitit 2020.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe	Literatura bazë është e mjaftueshme. Studentëve i ofrohen po kështu

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

19

<p>ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>shumë tituj në formatin elektronik të cilët gjenden në bibliotekë. Duke shqyrtuar syllabuset e paraqitura në dokumentacion shihet se literatura është e mjaftueshme sidomos ajo ndihmëse dhe pse në shumë raste është në gjuhë të huaj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka ka disa tekste të fushës që janë botuar në gjuhën angleze vitet e fundit. Vit pas viti pedagogët inkurajohen të porosisin libra të fushës së tyre të cilat sigurohen me fondet e universitetit [Takimi në Bibliotekë, Minutat e takimit]. Tekstet konsultohen si nga personeli akademik si nga studentët lehtësisht në ambientet e Bibliotekës.</p> <p>UAMD ka aplikuar politika të inkurajimit të hartimit të teksteve me shumë autorë për disiplina të cilat nuk kanë tekste bazë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka ka një numër të kufizuar librash fizikë. Ajo ka gjithsesi një numër të madh librash në format elektronik, rreth 15 000 tituj. Po kështu studentët dhe pedagogët mund të shfrytëzojnë sistemin EBSCO për të konsultuar artikuj e libra on-line. Në nivel universiteti gjithsej janë tre ambiente bibliotekë. UAMD disponon një bibliotekë mësimore e cila është në dispozicion të studentëve të programit të studimit dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të veçantë dhe në përputhje me misionin dhe detyrat e përcaktuara në Statutin e UAMD. [Vizita në bibliotekë].</p> <p>Biblioteka e UAMD ka nënndarjen e saj të lidhur me funksionin e promeve të studimeve të programet e studimit të Fakultetit i Shkencave Politike Juridike. Studentët e programit Master professional në Politika dhe Administrim me profil “Administrim Publik” kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekën elektronike të ofruara nga Biblioteka e UAMD. [RVB, Aneks 50, 128, 129 – Dok. Rregullorja e Bibliotekës UAMD; Vizita në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për programin e studimit Master, nuk nevojitet ndonjë strukturë e posaçme laboratorike. Thënë kjo në Kampusin e UAMD nuk pamë ndonjë ambient të dedikuar me kompjutera, i cili mund të përdoret për realizimin e detyrave të kursit ose për nevoja të tjera të tij.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Gjatë emergjencës Covid 19, personelit akademik i është dashur të përdorë mësimdhënien online. Nuk ka ndonjë platformë e-learning të cilën studentët e përdorin. Gjatë emergjencës janë përdorur platformat e lira si Zoom ose Google classroom.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Universiteti ofron një platformë online në të cilën studentët regjistrohen dhe aksesojnë informacione të ndryshme. Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë sistemin elektronik Pitagora përmes të cilit regjistrojnë lëndët që duhet të frekuentojnë sipas planit të studimit. Po përmes këtij sistemi gjenerohet dhe orari [shih Aneksin 108]. Nuk është e qartë se si studentët ose pedagogët e përdorin gjerësisht sistemin Pitagora. Mendojmë që ky sistem përdoret më së shumti nga administrata se sa nga studentët apo pedagogët për të shkëmbyer informacione të</p>

	ndryshme. UAMD përdor gjerësisht dhe sistemin Clean Score. Ky sistem ofrohet nga një partner i jashtëm i cili ofron platformën e dedikuar përmes të cilës korrigjohen provimet apo përpunohen të dhënat e pyetsorëve të ndryshëm.								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Njësia bazë por dhe UAMD kanë hartuar një udhëzues praktik për shkrimin e mikrotezës [Aneksin 68].								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni orienton njësitë bazë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Për këtë janë krijuar të ashtuquajturat ‘Grupet mësimore kërkimore shkencore’ (shih Aneksi 18, neni 19), që udhëhiqen nga një prej anëtarëve të departamentit. Detyrat e këtij grupi janë: -hartimi i kurrikulave që mbulon grupi -hartim program lëndësh të reja për tu propozuar në njësinë bazë -mbikqyrja e respektimit të programeve. Institucioni gjithësesi e ka orientuar politikën e jashtme në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë. Për këtë shfrytëzohen gjerësisht marrëveshjet Erasmus, sidomos ato që kanë të bëjnë me formimin apo trajnimin e personelit akademik por jo vetëm. [Aneksi 63-4, Mobilitete].
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësia bazë, ka krijuar tre ‘Grupe mësimore kërkimore shkencore’, të cilat respektojnë drejtimit studimore dhe kompetencat shkencore të anëtarëve të departamentit. Këto grupe bëjnë të mundur lidhjen mes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor [Aneksin 21, neni 11 dhe Aneksi 18, neni 18].
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Mësimdhënia në UAMD mbështetet në strukturën fikse të tre orëve të leksionit. Ka pak autonomi në këtë drejtim. Metodot inovative të mësimdhënies do të kërkonin një fleksibilitet në organizimin e mësimdhënies.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Kualifikimi shkencor i personelit akademik, përveç rastit kur ky i fundit kryen doktraturën në Universitet, i lihet në dorë vetë pedagogut. Nuk ka mbështetje për pedagogun, përveç revistës së Universitetit ose organizimit të konferencave shkencore në nivel Universiteti ku siç theksohet nga pedagogët, ata nuk janë subjekt i tarifave financiare që aplikohen. Pedagogët nuk financohen për konferenca jashtë shtetit por mbështeten në shfrytëzimin e programeve të shkëmbimit Erasmus+. Në

	anën tjetër, Universiteti mbështet projekte kërkimore shkencore me fondet e veta, të paktën për vitin 2017 [Aneksin 75.1].			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Nga rezultatet e vizitës nuk pati ndonjë indikacion përsa i përket metodave dhe trajnimeve. Trajnimet janë të rastësishme e lidhen me nevoja specifike të institucionit. Përshembull Universiteti ka implementuar përmes projektit Clean Score, metodën e korrigjimit elektronik të provimeve [Aneksin 109, Marrëveshje me ADF]. Kjo është shoqëruar nga një trajnim mbi projektin dhe hartimin e tezave. Po kështu shfrytëzohen për qëllime formimi dhe marrëveshjet Erasmus për pedagogët [Anekset 63 dhe 64].			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik është i kufizuar nga struktura e mësimdhënies. Ndryshimet në metodat e reja të mësimdhënies, në rastin e UAMD do të kërkonin gjithmonë një ndërhyrje nga Rektorati e më pas çdo ndryshim të zbatohet poshtë në mënyrë uniforme.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Nga diskutimet me personeli akademik të programit të studimit GVJ konstaton se ky i fundit nuk aplikon apo teston teknika të reja të mësimdhënies, e cila justifikohet me faktin se stafi nuk ka autonomi në përzgjedhjen apo në aplikimin e metodave të reja inovative. Fakt të cilin GVJ evidenton si mangësi nga dhe rekomandon <i>IAL të rrisë autonominë e stafit të saj akademik në këtë drejtim.</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Universiteti angazhon lektorë të ndryshëm të cilët mbulojnë tema me interes si për studentët dhe për pedagogët e ndryshëm. Po kështu Universiteti dhe njësi bazë përpiqen të ndërveprojnë me aktorë të ndryshëm si ambasada apo organizata të shoqërisë civile [Aneksi 33, Buletini i Aktiviteteve]. Këto të fundit bëjnë prezantime të ndryshme të cilat kanë lidhje me programet e studimit duke krijuar kështu një kulturë ndërveprimi me aktorë të jashtëm që operojnë në fushat e studimit të njësisë bazë. Për këtë mund të përmenden aktivitete si ‘Tryeza e Rrumbullakët “Mirëqeverisja-Ndërtimi i Besimit të Publikut”’ [Aneksi 130].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen	Kriteret e vlerësimit parashikohen në rregulloren e programit të studimit MPAP [neni 23, Aneksi 21]. Format e vlerësimit i komunikohen studentëve nga pedagogët çdo fillim kursi. Testimi i njohurive bëhet

nga studentët.	kryesisht me provimin me shkrim.			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kjo detyrë i përket pedagogut të lëndës i cili i komunikon studentëve programin, format e mësimdhënies dhe modalitetet e testimit. Të gjitha informacionet e nevojshme gjenden në sillabus, të detajuara [Aneksin 103-8].			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	UAMD ka një strukturë të ngurtë vlerësimi e përbërë nga katër komponentë: -provimi me shkrim -pjesmarrja në seminare -detyra kursi -projekte Pedagogu nuk ka autonomi në përzgjedhjen e formës së vlerësimit. Nëse kërkon formë alternative vlerësimi atehere duhet ta kërkojë me shkrim tek përgjegjësit e departamentit. Ky i fundit e miraton ose jo. Në rast mos dakordësie vendimi i takon Asamblesë së Departamentit. Komponenti më i rëndësishëm i vlerësimit mbetet provimi me shkrim, kryesisht me pyetje me alternativa. Pedagogët u shprehën se kjo formë është shumë e ngurtë por ndiqet rëndom si praktikë. Kohët e fundit UAMD po shfrytëzon projektin Clean score, korrigjimin elektronik të provimeve. Struktura e Clean score me atë të UAMD përputhet e kështu forma e testimit me pyetje me alternativa është bërë akoma e më e vështirë për tu ndryshuar nga pedagogët [Aneksi 19, neni 54].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i njohurive të studentit përmban tre komponentë përpos provimit me shkrim: -pjesmarrja në seminare -detyra kursi -projekte Qëllimi këtyre komponentëve të vlerësimit reflekton kontrollin e vazhdueshëm të dijeve gjatë vitit akademik [Aneksin 19, neni 54].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UAMD ka adoptuar që herët sistemin e vlerësimit me alternative dhe me çelës. Ky depozitohet përpara provimit në sekretarinë mësimore. Kjo metodë ka gjasa të shmangë abuzimet. Po kështu UAMD po përdor sistemin e kontrollit elektronik Clean score, të ofruar nga një projekt financiar nga Agjensia Amerikane e Zhvillimit. Ky system konsiston në leximin optik të provimeve, nxjerrjen e përpunimin në periudhë të shpejtë të rezultateve duke shmangur dhe gabimet e mundëshme [Aneksi

	109 për sistemin Clean Score; Minutat e takimit].			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Procesverbali final mban firmën e pedagogut, shefit të departamentit, kryesekretares dhe dekanit. Me gjasë ky mund të konsiderohet si një komision vlerësues [Aneksi 68, neni 58, pika 18].			
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Anonimiteti sigurohet nga vendimi i Këshillit të Fakultetit [Aneksi 132] por edhe nga përdorimi i sistemit Clean Score për korrigjimin e provimeve. Vendimi është detyrues për pedagogët, ndërsa sistemi Clean Score përdoret me diskrecionin e pedagogëve [Aneksi 109 për sistemin Clean Score; Minutat e takimit].			
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale nuk shoqërohet me feedback apo këshilla me qëllim përmirësimin në të ardhmen të performancës së studentit. Procedura dhe kriteret e vlerësimit parashikojnë vetëm përkthimin e vlerësimit me pikë dhe përkthimin e pikëve në nota. [Rregulloren e programit MPAP, neni 23, pika f].			
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Ky parashikim gjendet në rregulloren e UAMD posaçërisht në nenin 70 të saj [Aneksin 2, neni 70].			
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijes bazohen mbi meritën. Ato vlerësohen me provim me shkrim, i cili është anonym dhe ku zbardhja e emrit të studentit bëhet vetëm pas vlerësimit. Procesverbali dorëzohet në sekretari brenda 5 ditësh nga dita e provimit [Aneksin, neni 26]. Komunikimi i notës jepet sipas rastit nga pedagogu titullar i lëndës.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni garanton një procedurë ankimi nga studenti për vlerësimin, e cila vlerësohet nga një komision i ngritur posaçërisht. Ky komision në bazë të kërkesës procedon me ballafaqimin e testit me çelësin. Kjo procedurë parashikohet në rregulloren e UAMD. Studenti ka kohë tre ditë nga dalja e rezultateve të ankohet tek Drejtuesi i Njesisë kryesore i cili nëse e sheh të arsyeshme ja kalon atë Drejtuesit të njesisë bazë i cili procedon me ngritjen e komisionit vlerësues [Aneksin, neni 29].			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Kjo procedurë parashikohet në rregulloren e UAMD. Në analizën e rregullores së Arshivimit nuk paraqitet [Aneksi 136 Praktika e arshivimit].			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.7

#### Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

24



**studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programet e studimit janë organizuar në formën e rrethëve koncentrikë. Programet e studimit të ciklit bachelor orientohen drejt atyre të ciklit të studimeve master. Programi është hartuar duke patur parasysh jo vetëm studentët e UAMD por edhe të studentëve që vijnë universitete të tjera. Kështu për kategorinë e parë ofrohet avancim në njohuritë e marra gjatë programit të studimit të ciklit bachelor kurse për kategorinë e studentëve që vijnë nga universitete të tjera ofrohen disa lëndë bazë të cilat i vendosin ata në të njëjtin nivel si studentët e UAMD që frekuentojnë programine studimit të ciklit master [Aneksin 27. Kurrikulat].
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Qëllimi i programit të studimit është ofrimi i kapaciteteve dhe formimit të atyre që duan të jenë pjesë e administratës publike ose atyre që do të punojnë në fushën e administrimit në sektorin privat. Programi i studimit ofron lëndë të cilat zhvillojnë këto lloj kompetencash sikurse janë ato të Vendimarrje në Sektorin Publik të Avancuar, Politika Fiskale të Avancuara etj. Në këto lëndë specifikohen zhvillimet e aftësive të veçanta në teknologjinë e informacionit, komunikimin apo ndërveprimin në kuadrin e Administratës publike [Aneksin 27. Kurrikulat].
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Syllabuset tregojnë se çfarë aftësish do të marrin studentët pas mbarimit të një kursi. Në syllabuset e depozituara, përcaktohen objektivat e të nxëniet dhe aftësitë që studentët marrin në përfundim të çdo kursi. Këto janë të integruara me kapacitetet/aftësitë që përftohen pas mbarimit të programit të studimit [Aneksi 136].
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Elementët më të rëndësishëm apo makroçështjet që programi kërkon të zhvillojë ofrohen në syllabus e më pas ato reflektohen në testin përfundimtar. Është në në autonominë mësimdhënëse të çdo pedagogu dhe formës/mënyrës që ai përzgjedh për ti orientuar studentët në testin përfundimtar. Në syllabus, në kategorinë 'Vërejtje përfundimtare' pedagogu jep indikacione të përgjithshme mbi përmbajtjen e pyetjeve të provimit. [Aneksi 136].
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nuk është e qartë nëse personeli akademik realizon orë apo seminare të hapura pasi mungon dokumentacioni por të gjitha konferencat shkencore dhe aktivitetet jashtë kurrikulare në njësinë bazë janë të hapura për studentët. Konferencat apo aktivitetet akademike jashtë mësimore janë në përputhje me strategjinë e kërkimit shkencor të DAP.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Objektivat e programit janë të qarta. Mendohet se njëherë që mbaron programi, studentët janë në gjendje të aplikojnë në praktikë njohuritë/kompetencat e marra në auditor.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik mbështet diskutimin dhe punën në grup në varësi të lëndëve, teorike apo praktike dhe pse duhet theksuar që një prej komponentëve të vlerësimit është projekti për të cilin studentët punojnë gjithmonë në grup. Po kështu parashikohet në nivel Universiteti praktika

	e mentorimeve, ku secili pedagog ndjek përgjatë karrierës universitare një grup studentësh. Roli i pedagogut është ai këshillimit për arritjen e objektivave akademikë dhe orientimin në vazhdim të karrierës së studentit [Aneksin 98].								
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Njësia bazë ka një plan kërkimi shkencor i cili lidhet me fushën e studimit të programit. Po kështu njësia bazë organizon aktivitete të veçanta si vizita studimore pranë institucioneve të ndryshme apo përfshirjen në projekte të studentëve me aftësi të ndryshme [Analizën vjetore të DAP, f.22-23].								
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Për këtë kriter nuk ka informacione të sakta dhe të qarta. Universiteti mbështet më shumë aktivitete që mund ti shërbejnë si pjesë e formimit ekstrakurrikular të studentëve organizuar nga të tretë [Aneksi 33, Buletini i Aktiviteteve].								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	UAMD ka nënshkruar një sërë marrëveshjes për mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve. Nga biseda e bërë me studentët por sidomos me drejtuesit e DAP u vu re se njëri prej objektivave kryesorë të UAMD është ndërkombëtarizimi. Ky proces kryhet dhe nëpërmjet favorizimit të mobiliteteve të studentëve të universitetit [Aneksi 63 dhe 65]. Universiteti ka nënshkruar po kështu një sërë marrëveshjes dhe protokollesh bashkëpunimi me institucione simotra, aktorë të shoqërisë civile apo institucione kërkimore, objekti i të cilave është formimi dhe shkëmbimi i eksperiencave [Aneksin 58, 59.1 dhe 59.2].								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.8

#### Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Praktika profesionale zhvillohet jashtë institucionit, në institucione pritëse. Këto janë kryesisht insitucione publike me të cilat UAMD ka marrëveshje të posaçme bashkëpunimi të cilat favorizojnë kryerjen e praktikave profesionale nga studentët [Aneksin 60 dhe 61]. Rezultat i këtyre marrëveshjeve janë dhe praktikat shëmbujt e të cilave mund të shihen në [Aneksin 67].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	
<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në	

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

26

kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	një raport nga studenti. Këto dokumente përmbajnë vlerësimet përkatëse për performacën e studentëve. Praktika vlen 6 kredite ETSC e që është baraz me 120 orë të zhvilluara pranë institucioneve përkatëse [Aneksin 27, Kurrikulat].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.9</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar një procedurë të posaçme për zhvillimin e provimit përfundimtar dhe apo për mbrojtjen e diplomës [Aneksin 47, neni 2, pika 7 dhe 47.1]. Jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i vitit akademik, DAP u bën me dije studentëve procedurën e provimit të përgjithshëm përfundimtar të provimit. DAP po kështu ka përgatitur një udhëzues në formë pakete i cili i vjen në ndihmë studentëve për të përgatitur mikrotezën e diplomës [Aneksin 68].
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, për programin e studimit të ciklit master është parashikuar që në përfundim të studimeve, student të shkruaj një teze ose të japi provim final, por ajo që evedentua gjatë bisedës është se privilegjohet forma e provimit përfundimtar më shumë se sa shkrimi i mikrotezës. Çdo student ndiqet nga pedagogu përkatës, i cili përzgjidhet nga studenti në bazë të temave kërkimore të miratuara nga DAP [Aneksin 21, neni 21, pika 3 dhe 4 dhe Aneksin 68, pika 8].
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Ky kriter rregullohet nga paketa orientuese për praktikën dhe mikrotezën. Temat e diplomave përcaktohen paraprakisht nga DAP në formën orientuese, në bazë të kompetencave dhe fushave studimore të anëtarëve të njësisë bazë dhe DAP [Aneksi 21, neni 21]. Udhëheqësi zgjidhet nga studenti e më pas nënshkruhet një marrëveshje e cila depozitohet në sekretari e studentit i jepet përgjigje për pranimin e temës po nga sekretaria brenda pesë ditësh [Aneksin 68, Mikroteza pika 8].
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Ky kriter nuk rezulton në analizën e dokumentave të paraqitur nga DAP. Nisur nga analiza që mund t'ib ëhet paketës së praktikës e mikrotezës, mund të shprehemi se pedagogu udhëheqës ndihmon dhe mbikqyr punën e studentit në kryerjen e punimit të diplomës [Aneksin 68, Mikroteza pika 8].
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e	Kriteri bazë mbi të cilin ndërtohet raporti udhëheqës student është ai i

rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	mbikqyrjes. Në bazë të vlerësimit të udhëheqësit tema mund të kalojë ose jo për mbrojtje në komision. [Aneksin 68, Mikroteza pika 9].			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi bëhet me notë nga komisioni pas provimit përfundimtar apo mbrojtjes së mikrotezës. Në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë MPAP, parashikohen qartë format dhe mënyrat se si bëhet ky vlerësim [Aneksin 21, neni 21, pika 7].			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studenti pajiset me listë notash pasi ka mbrojtur me sukses mikrotezën apo ka kryer me sukses provimin përfundimtar. Më pas, dhe vetëm pasi ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj institucionit përkatës, në rastin konkret UAMD, ai pajiset me të gjithë dokumentacionin përkatës sikurse parashikon dhe ligji [Aneksin 68, Mikroteza, pika 18]. Përsa i përket suplementit të diplomës, nuk ka specifikime të veçanta si në rregulloren e programit të studimit MPAP [Aneksi 21, neni 21] si në në paketën për praktikën dhe mikrotezën [Aneksi 68, Mikroteza].			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studentit i vihet në dispozicion dokumentacioni që vërteton përfundimin e studimeve. Kopje të listës së notave, procesverbalet, amza, syllabuset apo kurrikula ruhen në format elektronik e mund të riprodhohen në çdo kohë [Aneksi 136, neni 25].			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Universiteti ruan dokumentacionin sikurse parashikohet në legjislacion. Për këtë institucioni ka hartuar një rregullore për arshvimin e dokumentacionit, përfshi dhe dokumentat e studentëve për të cilat parashikohet ruajtja në bazë të legjislacionit në fuqi. Parashikohen dy forma arkivimi, ajo fizike dhe elektronik. Dokumentacioni mund të konsultohet me kërkesë të personit të interesuar [Aneksi 136, neni 27].			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

##### Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit,

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

28

<b>vlerësimi dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>UAMD përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Zyra e burimeve njerëzore është përgjegjëse për mbajtjen e këtij informacioni. Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen në dosjen individuale të stafit, me të cilat u ballafaquam si GVJ gjatë vizitës në institucion. [Takim me përfaqësuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore (ZBNJ)]. Programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në Politika dhe Administrim me profil “Administrim Publik” ofrohet nga Departamenti Administrim Publik (DAP), pjesë e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike. Ky Departament drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe ka në përbërjen e tij, personel akademik me kohë të plotë, gjithësej janë 13 për vitin akademik 2018-2019 dhe 15 për vitin akademik 2019-2020, dhe me kohë të pjesëshme 17 dhe 27. [RVB, Aneks 81].</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD të gjithë veprimtarinë e tij, përfshirë edhe rekrutimin e personelit të ri dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore e realizon në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e UAMD. Në këtë program studimi, departamenti është kujdesur që të angazhojë pedagogë me grada e tituj shkencorë si dhe profesionistë. Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e universitetit, por edhe rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, Departamenti Administrimit Publik, në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat për personel akademik, paraqet kërkesat për plotësimin e vendeve vakante.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Gjatë gjithë procesit të rekrutimit institucioni është transparent me aplikantët duke i informuar hap pas hapi mbi mundësitë e punësimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik të parashikuara mbi bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Procedura e rekrutimit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerëzore e institucionit. Kandidatët vlerësohen dhe përzgjidhen sipas meritave nga komisioni Ad-Hoc i ngritur pranë departamentit. [RVB, Aneks 138 Takim me përfaqësuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore (ZBNJ)].</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedura nis me evidentimin e nevojës nga ana e njësisë bazë – Departamenti Administrim Publik (DAP). Transparencës dhe garancisë për të përzgjedhur personelin me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit i shërben “Paketa e BNP për rekrutimin e personelit akademik dhe praktika e ndjekur departament - dekanat-burime njerëzore-rektorat” [Aneks 138].</p> <p>Në këtë paketë jepen qartë mënyra e vlerësimit si për kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetet e vendit apo trojet, ashtu edhe për kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetet e huaja, duke vendosur një sistem pikëzimi që merr në konsideratë gjithë elementët e kërkuar për angazhimin si mësimdhënës. GVJ është i mendimit se, nëpërmjet kësaj procedure evitohen subjektivizmat, të cilat</p>

	mund të paraqiten gjatë procesit të rekrutimit për staf akademik.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Institucioni ka krijuar kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale, bazuar kjo në dokumentacionin e paraqitur (Statuti, rregulloret) si dhe takimet me Dekanin e FShPJ, Përgjegjësen e DAP dhe personelin akademik. UAMD ka pajisur zyrat e personelit akademik, të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. [Takime në institucion].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni realizon disa incentive të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Veprimtaritë kërkimore shkencore të personelit akademik të Departamentit të Shkencave Politike Juridike që mbulon dhe mësimdhënien në këtë program studimi, janë kontribut në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit dhe të kërkimit shkencor. Gjithashtu, prioritet ka qenë mbështetja në drejtim të kualifikimit duke u mundësuar pjesëmarrjen në konferenca shkencore. Dëshmi për përpjekjet në drejtim të kualifikimit është aktiviteti botues i konsiderueshëm i personelit akademik [Aneks 45]. [Aneks 75 75/1].
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Universiteti ka si objektiv trajnimin e personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Këtij objektiv i kanë shërbyer dhe i shërbejnë shkëmbimet me institucione të arsimit të lartë apo specialistë të huaj të fushës së administrimit në projekte kërkimore me partnerë kombëtar si për shembull, projekti i DAP-it financuar nga institucioni ‘Qeverisja dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm’) dhe ndërkombëtar, në programin Erasmus, si një mundësi për të përfituar nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave innovative të mësimdhënies. [Aneks 75 75/1].
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Nga takimet në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik zotëron kualifikimin e duhur dhe është i angazhuar maksimalisht për realizimin e procesit mësimor dhe për të mbështetur aktivitetet mësimore dhe kërkimore në përmbushje të objektivave të këtij program studimi. [Takime stafin akademik në institucion]. UAMD përpiqet të vendosë një balancë optimale midis organizimit dhe drejtimit të programit të studimit dhe numrit e cilësisë së anëtarëve të

	personelit akademik. Në informacionin e paraqitur në RVB [Aneks 114].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar DVV, RVB dhe vizitës në institucion [RVB, Aneks 122], Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Departamenti Administrim Publik, ka në dispozicion për të garantuar zhvillimin e programeve të studimit që mbulon një sipërfaqe rreth 730m <sup>2</sup> , me kapacitete 425 vende ulëse, ku përfshihen salla për leksione, seminare, salla për aktivitete promovuese, laboratorë informatike, bibliotekë, mjedis për fotokopjime, librari etj.). Veç këtyre disponon edhe mjedise për stafin si dhe rreth 525m <sup>2</sup> mjedise të tjera për studentët (zyrë informacioni për studentët, mjedise sportive, mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore etj.). Veç kësaj, procesi mësimor për programin e studimit Master Profesional në Politika dhe Administrim me profil “Administrim Publik” zhvillohet në fundjavë (e shtunë dhe e diel), duke bërë të mundur pasjen në dispozicion të hapësirave të mjaftueshme dhe cilësore dhe të respektohet kërkesa për hapësirën e nevojshme për student [RVB, Vizita në ambientet ku zhvilloj procesi mësimor].
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Për një zhvillim cilësor të procesit mësimor, Institucioni ofron mjediset e nevojshme për këtë program studimi. [RVB, Vizita në ambientet ku zhvilloj procesi mësimor, Aneks 49 - Dok. Manual Aula UAMD; Aneks 123 – Dok. 2019-2020 Tabela per Vleresimin e Kapaciteteve 2019-2020]
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Programi i studimit pretendon se ka në dispozicion laboratorë mësimorë informatike, dhe auditore të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Gjatë vizitës nuk u pa një laborator i tillë.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit	Institucioni deklaron se ofron laboratorë të teknologjisë së informacionit që janë në dispozicion e mund të përdoren nga të gjitha programet e studimit në varësi të specifikave dhe nevojave që kanë. [RVB, Aneks 122, 53]

që ofron.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Kapacitetet e UAMD dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. UAMD garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive në institucion sikurse dhe bashkëpunon me institucione dhe organizata të tjera në vend në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. [Takimet me anëtarët e GVB dhe studentët]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në nivel universiteti gjithsej janë tre ambiente biblioteke. UAMD disponon një bibliotekë mësimore e cila është në dispozicion të studentëve të programit të studimit dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të veçantë dhe në përputhje me misionin dhe detyrat e përcaktuara në Statutin e UAMD. [Vizita në bibliotekë]. Biblioteka e UAMD ka nëndarjen e saj të lidhur me funksionin e promeve të studimeve të programet e studimit të Fakultetit i Shkencave Politike Juridike. Studentët e programit Master profesional në Politika dhe Administrim me profil “Administrim Publik” kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekën elektronike të ofruara nga Biblioteka e UAMD. [RVB, Aneks 50, 128, 129 – Dok. Rregullorja e Bibliotekes UAMD; Vizita në institucion]
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Literatura te Biblioteka është e bollshme (rreth 12000 tituj) me botime në shqip, anglisht dhe gjuhë të tjera. Biblioteka ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online. Ekziston nevoja që Biblioteka të prodhojë dhe azhurnojë rregullisht listën e titujve sipas programeve të studimit, gjë që duhet të shikohet si një mundësi më e mirë për studentët, pasi gjatë takimeve na u tha që mungonte literature bazë për një pjesë të moduleve [RVB, fq. 40-41; Dok. Rregullorja e Bibliotekes UAMD; Vizita te institucioni].
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Studentët e këtij programi studimi, kanë mundësinë të shfrytëzojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. [RVB, fq. 41; Aneks 128 – Dok. Manual Biblioteka Online; Aneks 129 – Dok. Biblioteka Online të dhëna mbi materialet e disponueshme; Vizita te insitucioni]
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa	Në ambjentin e Bibliotekës ndodhet salla e kompjuterave e cila mundëson përdorimin e kompjuterave, zhvillimin e aktiviteteve, trajnim mbi përdorimin e katalogut online, etj. Biblioteka mundëson kërkim të



<p>kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>informacionit on-line, në sallën e leximit, skedarë elektronikë, lehtësira në kërkimin bibliografik të informacionit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës. Biblioteka e UAMD ka Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit. Përveç përshkrimit bibliografik, katalogu ofron falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të UAMD-së. UAMD është gjithashtu abonuar në libraritë elektronike siç janë EBSCO, JSTOR, biblioteka dixhitale që përmbajn revista akademike të cilat mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. UAMD është gjithashtu pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore. Si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëri dhe përmes Projektit ERA2012 (Electronic Resources for Albania), lexuesit përfituan akses në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë. UAMD fitoi statusin “EU Info Point” me anë të si cilës në bibliotekën e UAMD-së mbërrijnë periodikisht publikime nga Zyra e Publikimeve të BE-së në Luksemburg. Njekohesisht, Biblioteka e UAMD është pjesë e ALASE – Albanian Academic Search Engine, aksesueshme nga <a href="https://ulibrary.rash.al">https://ulibrary.rash.al</a> [RVB, fq. 41; Aneks 128 – Dok. Manual Biblioteka Online; Aneks 129 – Dok. Biblioteka Online të dhëna mbi materialet e disponueshme; Vizita në institucion]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UAMD ka hartuar dhe zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve të studimit, megjithë fondet relativisht të kufizuara. Kërkesat për pasurimin e fondit të Bibliotekës vijnë nga departamentet.</p> <p>Të disponueshme janë leksionet në gjuhën shqipe në shërbim të programit të studimit, të mundësuar nga vetë titullarët e lëndëve, por duhet thënë që literatura në gjuhë shqipe dhe të huaj është akoma relativisht e kufizuar. [Vizita në bibliotekë].</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të premtë dhe orari i funksionimit të Bibliotekës është 08.00-16.00. Shërbimi i informacionit elektronik mbetet i hapur nga e hëna në të diel 08.00-20.00. Oraret e shërbimit të bibliotekës janë përshtatur me oraret e programit të studimit dhe me nevojat e studentëve. [Vizita në institucion).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon	Sistemi i UAMD disponon një sistem elektronik të menaxhimit të

<p>sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>informacionit. Ky sistem informatik realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit nga regjistrimi deri në diplomim. Gjithashtu, programi nuk posedon regjistrat e veta për gjeneralitetet dhe për arritjet akademike; të dhënat e studentëve rruhen në Excel, i cili nuk siguron sigurinë e të dhënave. UAMD përmban informacionin personal të studentit dhe e-mail adresat e tyre për informimin për aktivitete të ndryshme. Studentët informohen nga faqe zyrtare e internetit të institucionit <a href="http://www.uamd.edu.al">http://www.uamd.edu.al</a>, rrjetet sociale, në mjediset publike të ndërtesave të universitetit. Faqe zyrtare e internetit të institucionit posedon informata të limituar për programin Master professional në "Politika dhe Administrim" me profil "Administrim Publik" Menaxhimi dhe përditësimi të faqës zyrtare e internetit duhet të sinkronizohet me punën ditore të departamenteve. UAMD nuk u ofron studentëve e-maile me domainin e universitetit; studentët dhe në shumë raste stafi, përdorin adresat e tyre personale të postës elektronike. [RVB, fq. 42; Takimet me anëtarët e GVB, stafi akademik, Dekani i FShPJ/Përgjegjësi i DAP, Sekretaria mësimore dhe studentët). UAMD administrojnë informacionin e plotë të stafit akademik [Takime në institucion, RVB Aneks 114, 136, 138].</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>UAMD disponon dokumentacionin e nevojshëm me informacionet mbi stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe për stafin administrativ. Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNj) disponon dosjet e të gjithë stafit akademik (PAE, PAK) dhe administrativ që prej aplikimit të tyre. Dosjet përditësohen me çdo dokument të fituar nga anëtarët e stafit përgjatë punës së tyre dhe dokumenti shtohet në dosje (p.sh një diplomë shtesë, një çertifikatë, publikim/botim në revistë shkencore etj). Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore u përzgjedhën dy dosje rastësore një PAE dhe një PAK, të cilat rezultuan me dokumentacionin e plotë. [Takime në institucion, RVB Aneks 66].</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit studentët dhe pedagogët përdorin edhe platforma të tjera komunikimi elektronik [Takim me studentët dhe stafin akademik].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna për organet drejtuese dhe titullarët. [Takim me anëtarët e GVB dhe Dekani i FShPJ/Përgjegjësi i DAP me studentët dhe stafin akademik].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Në faqen e internetit të UAMD gjendet vetëm informacion për kurrikulën e programit të studimit. Faqja në internet është kryesisht në gjuhën shqipe; mungon informacion në anglisht [RVB, fq. 42; Takimet me anëtarët e GVB dhe Dekani i FShPJ/Përgjegjësi i DAP; vizitë në faqen e internetit të institucionit].</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>			
	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Që me urdhrin për hapjen e këtrij program studimi, shprehet qartazi se ky program financohet nga të ardhurat e UAMD-së. [RVB, Aneks 93 dhe Aneks 17 (raporti financiar I UAMD)]. Buxhetimi financiar në nivel institucional hartohen çdo vit. Raportet financiare hartohen në bazë institucioni dhe janë të ndara sipas programeve në cikle dhe specifike për programet e studimit. Sipas raporteve financiare të institucionit, kostot e programit të studimit shkojnë rreth 11000 euro në vit. [RVB, Aneks 81 – Dok. Tabelat per kostot e programit e studimit].
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtje e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiarë grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Plani i financimit hartohet në nivel institucional dhe përmban elemente financiare në bazë programi .[RVB, Aneks 81 dhe 17]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	UAMD i nënshtrohet çdo vit një audit të brendshëm, të kryer njësisia e Auditimit të brendshëm dhe të drejtuar nga Bordi i Administrimit. Në raportin vjetor paraqiten, zërat e shpenzimeve dhe të ardhurat e institucionit. Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Institucioni ndjek një politikë transparente të shpërndarjes së burimeve financiare. Nuk ka informacion nëse dhe cila kompani e auditimit të jashtëm kryen auditimin e jashtëm të UAMD në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit [RVB, 43; Aneks 15 – Dok. Raport 5 Vjekar Veprimtarisë Auditit].
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Plani i financimit hartohet në nivel institucionit dhe përmban elemente financiare për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit [RVB, Aneks 81.]
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton	Referuar “Raportit të veprimtarisë financiare për vitin akademik 2018-

qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	2019” dhe Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, rezulton se UAMD garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimi dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen [RVB, Aneks 81.] megjithatë, GVJ është i mendimit se në dokumentacionin e vënë në dispozicion, përveç raportit të veprimtarisë financiare, nuk u vërejt një analizë e hollësishme financiare për programin e studimit “Politika dhe Administrim me profil “Administrim Publik”.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UAMD është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, ligji 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Senatit Akademik. Në Statutin e UAMD-së dhe Regullorja e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, Departamenti Administrim Publik dhe të programit të studimit Master Profesional në Politika dhe Administrim, me profil “Administrim Publik” shprehen qartë procedurat e aplikimit.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në bazë të dokumentacionit të shqyruar, rezulton se politikat dhe procedurat e ndjekura nga hyrja në dalje për çdo kandidat për student apo student, janë të njëjta.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në fillim të vitit akademik, strukturat e IAL-së , (fakulteti dhe njësia bazë përgjegjëse), ofron për kandidatët për studentë apo studentët në UAMD, mundësinë për të aksesuar kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit [Aneks 21 , Neni 30,31,32]

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

36

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>DAP përcakton kuotat, kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues brenda vitit paraardhës kalendarik, për të gjitha programet e studimit që ofron, kjo në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Për të ndjekur programin e studimit Master Profesional në Politika dhe Administrim, me profil "Administrim Publik", institucioni përmes vendimeve të Senatit Akademik mund të përditësojë apo vendosë për kritere shtesë krahas atyre të përcaktuara nga Udhëzimi i Ministrisë, të cilat bëhen publike. [Aneks 97].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Informimi dhe orientimi për kandidatët për studentë apo për një publik më të gjerë, lidhur me kërkesat apo kriteret e përgjithëshme, realizohet në disa forma si: takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Gjatë vizitës në UAMD dhe referimit të studentëve të këtij programi studimi, por edhe përmes dokumentacioneve përkatëse, institucioni mundëson një informacion lidhur me njohjen e ecures akademike nga studentët në kohë reale. [Aneks 13]. Studentët e regjistruar pranë këtij programi, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatoren e programit të studimit dhe përgjegjësin (tutorin) e grupit të tyre mësimor mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik. Studentët informohen në lidhje me kurset e detyrueshme dhe me zgjedhje, praktikën profesionale dhe temën e diplomës. [Aneks 68, Paketa e udhëzimeve].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>UAMD ndjek dhe harton procedura mbi njohjen e transferimet e krediteve dhe mobilitetin, i bazuar tek realizimi i procedurës dhe informimit të studentëve mbi këto procese. Në rastet e transferimit të studimeve, dosja e kandidatit shqyrtohet nga një komision ad hoc, në përputhje me rregulloren e programit të studimit. [Aneks 13].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik dhe fillim të çdo semestri, studentët informohen nga stafi akademik mbi procedurat e vlerësimit të dijeve. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit parashikohen në Syllabuset e lëndëve, duke ju dhënë atyre mundësi të plotësojnë njohuritë dhe sqarojnë paqartësitë gjatë dhe në fund të procesit mësimor. Këto kritere dhe procedura janë të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimi Master profesional në "Politika dhe Administrim" me profil "Administrim Publik". Ky informacion do duhej të aksesohet e të ishte i plotë edhe në faqen zyrtare të institucionit apo departamentit. [Aneks 21, Neni 23].</p>

*D. Jey* *elby*

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në kurrikulën e programit të studimeve Master profesional në “Politika dhe Administrim ” me profil “Administrim Publik”, Departamenti i Administrimit Publik, ku ofrohet dhe ky program studimi, ju mundëson studentëve udhëheqje dhe mbikëqyrje përgjatë shkrimit në përgatitjen e mikrotezës së masterit duke organizuar seanca informimi. Studentët janë udhëzuar edhe përmes adresave të tyre elektronike mbi procedurat e punimit. Vërehet mungesa e një manual udhëzues “Si të shkruajmë një temë diplome”përveç rregullores së programit të studimit Master profesional në“Politika dhe Administrim ”me profil “Administrim Publik”, master professional, për t’i orientuar studentët në lidhje me rregullat, udhëzimet, njohjen me infrastrukturën që kanë në dispozicion nga departamenti për realizimin e disertacionit të tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të. Institucioni ka disa forma për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit Master profesional në“Politika dhe Administrim ” me profil “Administrim Publik”, konsistojnë në takimet e Departamentit për studentët e interesuar, materialet informuese, faqja zyrtare e institucionit, etj. [RVB Aneks 99 Takimet në institucion me studentët e këtij program studimi].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi V.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Ky lloj informacioni, lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, ofrohet nga Departamenti Administrim Publik si njesia bazë, që nga momenti që studenti fillon studimet. UAMD, nëpërmjet strukturave të veta, departament, staf akademik dhe sekretaria mësimore, siguron menaxhim të informacionit në lidhje me programin e studimit. Si një kanal i rëndësishëm i komunikimit dhe informimit do ishte dhe faqja eeb e institucionit ku nuk ka një informacion të detajuar për programin që po analizojmë, përveç planit mësimor. Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Master profesional në “Politika dhe Administrim ” me profil “Administrim Publik”, është 1 vit akademik i organizuar me 2 semestra dhe realizohet me 60 ECTS në përputhje me ligjin 80/2015. Edhe nga takimi me studentet u vu re se ata ishin të mirë informuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe organizimin e programit të tyre. [RVB; Aneks, 21 24].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në</p>	<p>Informacionet për programet e studimeve, të drejtat dhe detyrimet e</p>

dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	studentëve apo të tjera informacione të rëndësishme u vendosen në dispozicion studentëve si në format të shkruar, ashtu edhe online. Informacioni për syllabuset e lëndëve u bëhet me dije studentëve në nisje të secilit modul, prej pedagogëve përgjegjës të lëndëve, njësisë bazë dhe nëpërmjet broshurave informuese. [RVB; Aneks 105].			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Studentëve u vihet në dispozicion ky informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit, në përfundim të programeve të studimeve. Konkretisht, Zyra e Këshillimit dhe Karrierrës informon dhe bënë njoftime për mundësi punësimi. Vërehet mungesa e një studimit të mirëfilltë të tregut të punës në nivel fakulteti dhe departamenti si dhe mbështetje aktive institucionale për orientimin drejt këtij tregu. Aktivitetet në këtë drejtim janë të kufizuara.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Stafi akademik dhe njësi të tjera administrative, gjatë takimeve dhe seancave të orientimit, që mbahen gjatë javës së parë, informon studentët e rinj mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, kalendarin akademik, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Stafi akademik i programit Master profesional në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Publik”, përmes postës elektronike ndan këtë informacion me studentët që ndjekin programin e studimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Sistemi ekzistues ishte i bazuar në kontaktet e studentëve me Sekretarinë Mësimore, Departamentin dhe stafin akademik duke mundësuar komunikimin midis të gjithë këtyre aktorëve, për çdo informacion që lidhet me organizimin e programit mësimor.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni mban të dhëna statistikore mbi numrin e të regjistruarve, transferuarve dhe të larguarve nga programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe të dhëna mbi ecurinë e studimeve të tyre, që nga pranimi deri në diplomim.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në	Gjatë vizitës së realizuar në institucion dhe takimin me Sekretarinë Mësimore, GVJ-së iu vunë në dispozicion të dhëna që lidheshin me

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

39

programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin e studimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni nuk mban statistika sistematike për studentët aktivë dhe të diplomuar nga programi Master profesional në "Politika dhe Administrim" me profil "Administrim Publik".			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni ruan, administron dhe përpunon të dhënat e studentëve, atyre akademike, dhe raporteve statistikore, etj. Këto informacione e statistika nuk menaxhohen përmes ndonjë sistemi informatik dhe të sigurtë.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjestrave	Institucioni përmes Zyrës së Zhvillimit dhe Karrierës dhe Alumnit, përmes kontakteve telefonike dhe komunikimit me e-mail me të diplomuarit, harton një bazë të dhënash mbi punësimin e tyre dhe mbi ndjekjen e studimeve të mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në statutin dhe rregulloret e UAMD studentët përfshihen në disa struktura si: Senati Akademik; Këshillat studentore; Komisionin e sigurimit të cilësisë; Komisione ad hoc, etj. Studentët gjithashtu angazhohen për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet anketimeve. [RVB, fq. 49-50; Aneks 1 – Dok. Statuti UAMD; Aneks 2 - Dok. Rregullore UAMD; Aneks 19 – Dok. Rregullore e FShPJ; Aneks 46 – Dok. Rregullore e DAP; Aneks 21 – Dok. Rregullore e programit të studimit]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Angazhimi i studentëve është konkret, pasi ata janë vendimmarrës në disa struktura të univerisitetit. Të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies përmes Njësisë e Sigurimit të Cilësisë, bëhen pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës. Rezultatet e këtyre instrumentave trajtohen në nivel të strukturave drejtuese.



<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit Master profesional në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Publik”, është i organizuar në dy semestra me module lëndësh, përfshi një pjesë të semestrit të dytë që i kushtohet përgatitjes së mikro-tezës. Modulet e lëndës vlerësohen sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Studentët që kanë përfunduar një program studimi kanë të drejtën të ndjekin një program të dytë studimi, në të cilin ata mund të përdorin kreditet e grumbulluara në programin e parë të studimit, për lëndë ose module të ngjashme, ose të njëjta. Për ndjekjen dhe vlerësimin e këtij procesi është ngritur një komision i posaçëm ad hoc, që vlerëson këto, në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Departamenti Administrim Publik, organizon takime në formatin e hapur për studentët. Ata shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në lidhje me programin. Në takimin me studentët, ata u shprehen pozitivisht për punën e Departamentit dhe të stafit akademik dhe atij administrativ në organizimin e takimeve të hapura me studentët e programit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregulloret e Universitetit përcaktojnë procedura në rast ankese nga studenti. Studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pa llogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim te Dekani i Fakultetit – FSHPJ. Institucioni nëpërmjet NjSBC-së përdor metoda të drejtpërdrejta dhe mjete të tërthorta vlerësimi, ku studentët kanë mundësi të shprehin mendimin, vlerësimin dhe kërkesat e tyre duke plotësuar pyetesoret, ku vlerësojnë pedagogun, lëndën, stafin administrativ, etj. Të cilet realizohen në javën e fundit të çdo semestri [Aneks 134 – Dok. Analiza pyetesoreve; takimet me studentët, stafi akademik, Dekani i FSHPJ dhe Përgjegjësi i DAP].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike Juridike si Njësi Kryesore, ka në strukturën e tij Sekretarinë Mësimore e cila realizon informimin, mbështetjen dhe ndjekjen e studentit gjatë gjithë viteve të studimeve. Gjithashtu, Departamenti dhe stafi akademik ndihmojnë studentët në zhvillimin e tyre personal, shoqëror dhe akademik, duke bërë të mundur një eksperiencë të studiuar sa më të mire, në përputhje këto me</p>

	parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-se. [Takimi me studentët]			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Ky sistem i përbërë nga Sekretaria Mësimorë dhe Departamenti, gjithashtu dhe nga Zyra e Komunikimit, Alumnit, dhe Karrierës, shërbejnë si burime të informacionit dhe këshillimit rreth mundësive të studimit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomim. Njëkohësisht, ekziston sistemi i “mentorimit” të studentëve nga stafi akademik që ka për qëllim mbështetjen e studentëve në procesin mësimor.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në nivel universiteti funksionon “Zyra e Komunikimit, Alumnit, dhe Karrierës”. Kjo zyrë e zhvillon aktivitetin e saj në shërbim të informimit e këshillimit të karrierës dhe vë në dispozicion të studentëve materiale informuese për ti orientuar ata për të njohur organizimin e institucionit si dhe të drejtat e tyre nëpërmjet këtyre informimeve për zhvillimin e karrierës, por njëkohësisht orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilën do të zhvillojnë praktikën profesionale. [ RVB, fq. 55; Aneks 52- Doc Rregullore Sektori I Komunikimit, Alumnit & Karrierës]			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Institucioni nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Alumnit, dhe Karrierës” angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë ciklit të studimeve dhe mbajnë kontakte të mëvonshme. Institucioni zotëron statistika mbi punësimin e studentëve të diplomuar në programin studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

42

*[Signature]* *[Signature]*

**posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni bazohet në Statutin e tij, ku janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC), ku edhe njësia bazë – DAP ka një përfaqësues.</p> <p>(DKSC) është e organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyrën e Sigurimit të Cilësisë;</li> <li>- Degën Mësimore;</li> <li>- NJBSC në nivel fakulteti [Evidencë 92].</li> </ul> <p>Kjo njësi është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit, dhe ka për detyrë paraqitjen e informacioneve dhe vlerësimeve për procesin e mësimdhënies, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrevë të cilësisë në të ardhmen. Strukturë tjetër e rëndësishme në sigurimin e brendshëm të cilësisë është edhe Zyra për Sigurimin e Cilesise dhe Vleresimit Institucional, e cila funksionon brenda DKSC-së si edhe Komisioni i Përherëshëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese. Një element i rëndësishëm është dhe angazhimi i studentëve në këtë proces, kjo në funksion të përmirësimin të parametrevë të cilësisë në të ardhmen si dhe bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat realizohen në fund të çdo semestri.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Institucioni gjithashtu i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit nga autoritetet kombëtare. Në akreditimin institucional në vitin 2016, UAMD u vlerësua me një akreditim për 4 vite akademike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e sistemit të brendshëm të cilësisë UAMD struktura përgjegjëse DKSC programon punën dhe ndjek në mënyrë permanente procedurat. Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese në nivel të njësive bazë, kryesore dhe institucionale. [Evidencë 12, pika 8].</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk</b>      <b>Përmbushet</b>      <b>Përmbushet</b>      <b>Përmbushet</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

43

standardit	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Pranë FSHPJ është ngritur NJBSC në nivel fakulteti [RVB Aneks 92], e cila kujdeset për zhvillimin korrekt dhe rishikimin në përputhje me standardet e cilësisë të programeve të studimit.								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Programet e studimeve dhe syllabuset rishikohen çdo fillim viti akademik, me pjesëmarrjen e grupeve të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë, ku struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është DKSC-ja, brenda së cilës është edhe Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional, dhe Komisioni i Përherëshëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Zyra Mesimore si pjesë e DKSC realizon aktivitetet me karakter monitorues për vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit. Sistemi i instaluar (anketimi i studentëve) dhe funksionimi i DKSC-së me struktura të lidhura janë tregues të metodologjisë së vlerësimin. [RVB, fq. 60-61; Aneks 2, 12].								
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raportet e realizuara nga DKSC-ja dhe nga struktura të ndërlidhura janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Rezultatet e vlerësimin të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse [RVB, fq. 59, 60-61; Aneks 9]								
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimin duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimin dhe masat e marra për adresimin e mangësisve dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet e vlerësimin përfshijnë tregues kyç të performancës për të analizuar kontributin e punës në arritjen e objektivave strategjike institucionale. Trajtimi i rezultateve të vlerësimin në institucion bëhet në disa nivele. Monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësisve të konstatuara realizohet nga DKSC, por edhe nga Fakulteti dhe Departamenti.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Departamenti i Administrimit Publik që është dhe përgjegjës i këtij program në bashkëpunim me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë realizon vlerësim në nivel institucional për të gjitha programet e studimit. Relacionin specifik në bazë programi e harton njësia kryesore - FShPJ dhe njësia bazë - DAP. Ata realizojnë analiza të përgjithshme dhe specifike për programin. Këto raporte vetvlerësimi nga ana e departamenteve shqyrtohen nga DKSC-ja për realizimin e vlerësimit të përgjithshëm. [Aneks 12].</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni përdor disa instrumeta për realizimin e procesit të vlerësimit, si raportin e veprimtarisë mësimore e kërkimore – shkencore mbi analizën e programeve të studimit, veprimtarisë së kërkimit shkencor dhe elementëve të tjerë, pjesë e jetës universitare, të siguruar këto nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit [Aneks 9, 18].</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor metoda të tërthorta si sondazhe të studentëve që ndjekin studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, programin e studimit Master Profesional me profil “Administrim Publik” etj. Në UAMD përveç NJSBC, Departamentit të Administrimit Publik, si njësi bazë e ofrimit të programit të studimit, angazhohen edhe zyrat e tjera të institucionit. [RVB, fq. 59; Takimet të institucionit].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Si pjesë e rëndësishme e organizmit të UAMD-së, është inkurajimi i studentëve të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet përfaqësuesve, janë pjesë e Senatit, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të UAMD, Këshillave Studentore, etj, por në takim u vu re se mungonte ky përfaqësues nuk ishte aktiv si pjesë e sigurimit të cilësisë së programit. Gjithashtu, DKSC realizon takime me stafin dhe studentët. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së programit të studimit. CleanScore i mbështetur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan zbatohet në UAMD me synim rritjen e transparencës nëpërmjet korigjimit të automatizuar të testimeve. [Aneks 110 - Dok. Anketimi i studenteve nga dega mësimore; Takimet në institucion.]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<b>Standardi VI.4</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të programit të studimit Master Profesional në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Publik”, institucioni në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. [Aneks 5& 8] Institucioni ka shperndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (Departament, Fakultet, Rektorat) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to .			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësitë dhe detyrat e njërive të angazhuara janë të përcaktuara në kuadrin ligjor mbi të cilin funksionon UAMD dhe te dokumentet institucional që rregullojnë veprimtarinë e lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javën orientuese sqaron studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional. [Aneks 2; Takimet në institucion.]			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Komisioni i Përhereshëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe struktura të tjera për sigurimin e cilësisë përbëhen nga stafi akademik, personeli ndihmës akademik, stafi administrativ, studentët, dhe ekspert i jashtëm. [ RVB fq 63; Takimet në institucion; Aneks 2;12]			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Ka disa standarte të cilat respektohen për përzgjedhjen e anëtarëve të strukturave për sigurimin e cilësisë. Ata, ndër të tjerat, nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të universitetit, dhe duhet të kenë kualifikimet e nevojshme profesionale. [RVB; Aneks 55 ]			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Institucioni ka përfshirë dhe angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të bëjnë ekspertizë në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. [RVB, fq.64, Aneks 2]. Gjatë takimeve në Institucion nuk mundëm të takonim asnjë nga këta ekspertë të jashtëm.			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

*Handwritten signatures in blue ink.*

standardit				X
------------	--	--	--	---

<b>Standardi VI.5</b>				
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucion është transparent me studentët dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të SBC. GVJ gjatë vizitës, konkludoi se studentët dhe stafi kishin informacion të konsiderueshëm lidhur me veprimtaritë e Institucionit në funksion të SBC. [Aneks 13; Takimet në institucion.]			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në UAMD, NjSBC, informon në mënyrë periodike Rektoratin, drejtuesin e Fakultetit, përmes tyre në mënyrë konfidenciale dhe të gjithë stafin akademik, rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisë të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. [RVB, fq.64, Aneks 12].			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni realizon një proces vijueshmërie të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat e raporteve të vlerësimit. Vlerësimet pasqyrohen te raportet vjetore të departamentit, fakultetit dhe universitetit. Rezultatet shfrytëzohen në mbështetje të procesit të procesit vijueshmërisë në vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të semestrit ose vitit akademik. [RVB, fq.65, Aneks 3].			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti analizon të dhënat dhe nxjerr në pah çështjet dhe situatat për përmirësim, me qëllim rritjen e performancës së mësimdhënies dhe përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, dhe ndërveprimet të të gjithë faktorëve përbërës së Universitetit. Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara nëpërmjet pyetësorëve, janë marrë masa edhe pse gjatë takimeve nuk na u përmend rast konkret.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Fakulteti i Shkencave Politike Juridike si njësi kryesore dhe Departamenti i Administrimit Publik, si njësi bazë realizonin aktivitetet dhe veprimtari, siç janë takimet të hapura në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik, duke i informuar ata dhe duke nxitur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

47

*Handwritten signature: Drey*

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programit i studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik” është një prej programeve që perforcon traditën e UAMD-së në fushën e Administratës Publike, gjithashtu edhe ku Departamenti i Administrimit Publik angazhon pjesën më të madhe të burimeve njerëzore.
2. Kurrikula e këtij programi studimi është hartuar duke patur parasysh nevojat e Administratës Publike.
3. Koordinimi i mirë mes administratës dhe njësive bazë për realizimin e objektivave që ka universiteti, sikurse ndërkombëtarizimi apo bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike dhe private.
4. Infrastruktura e kampusit të ri universitar është një prej pikave të forta të Universitetit, por jo vetëm, edhe vetë programit të studimit pasi kampusi është i projektuar specifikisht me të gjithë mjetet dhe hapsirat e duhura për zhvillimin e mësimin në kushte optimale dhe të përshtatshme për studentët.

**Pika të dobëta**

1. Programi i studimit Master Profesional “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik” nuk posedon regjistrat fizikë për gjeneralitetet dhe për arritjet akademike të studentëve; të dhënat e studentëve ruhen në Excel, i cili nuk garanton kushtet e duhura për sigurinë e të dhënave. Kjo mungesë ve në rrezik diplomimin e studentëve dhe çënon besimin e tyre ndaj Universitetit.
2. Mungesa e komponentit të gjuhës së huaj në programin e studimit Master Profesional “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik” ndikon negativisht në ndërkombëtarizimin dhe mundësitë e mobilitetit të këtij programi studimi.
3. Mungesa e informacionit më të plotë në faqen zyrtare të UAMD, dhe më specifikisht për programin e studimit Master Profesional “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik”.
4. Mungojnë ambientet e përshtatshme për zhvillimin e orëve studimore nga ana e studentëve. Salla e bibliotekës, e cila shërben edhe si sallë studimi, është e pamjaftueshme për të gjithë studentët e UAMD.

**Rekomandime**

1. Rekomandohet që UAMD të sigurojë sa më shpejtë të jetë e mundur regjistrat fizikë për mbajtjen e evidencave të studentëve për programin e studimit Master Profesional “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik”.
2. Rekomandohet që insitucioni, të intensifikoji përpjekjet në drejtim të sigurimit të informacionit më të gjerë e plotë publik në faqen e internetit. Për një mbarëvajtje sa më të mirë të programit të studimit dhe për të siguruar një harmoni të programit të studimit me publikun më të gjerë, është e nevojshme që të pasurohet faqja zyrtare web.



3. Rekomandohet te shtohet gjuha e huaj si komponent i kurrikulës së këtij programi studimi.
4. Rekomandohet të rritet autonomia e pedagogëve në përzgjedhjen e metodave të vlerësimit të studentëve.
5. Pavarësisht se ne Rregulloren e Programit të Studimit parashikohet që në përfundim të këtij programi studimi studenti duhet të përgatisë një mikrotezë, momentalisht praktika e zgjedhur është ajo e zhvillimit të një provimi përfundimtar. Rekomandohet zbatimi i drejtë i rregullores në fjalë.
6. Rekomandohet zgjerimi i sallës së bibliotekës ose përshtatjen e ambienteve të dedikuara si salla studimi, për të bërë më të aksesueshëm për studentin këtë facilitet.

**Conclusions of the evaluation of the second cycle, Professional Master "Policy and Administration", with the profile "Public Administration" of the "Aleksander Moisiu" University, Durres.**

**a. Strengths and affirmations:**

1. The study program of the second cycle, Professional Master "Policy and Administration", with the profile "Public Administration" is one of the study programs that strengthens the tradition of UAMD in the field of Public Administration, also where this Department engages most of its human resources.
2. The curriculum of this study program is designed taking into account the needs of Public Administration.
3. Good coordination between the institution's administration and the basic unit for the realization of its objectives, such as internationalization or cooperation with various public and private institutions.
4. The infrastructure of the new campus is one of the main strengths of this University, but not only in general, but also specifically regarding the study program itself as the campus is specifically designed with all the necessary tools and spaces for the development of learning in optimal and appropriate conditions for students.


**b. Weak points:**

1. The study program of the second cycle, Professional Master "Policy and Administration", with the profile "Public Administration" does not have physical registers for generalities and academic achievements of students; student data is stored in Excel, which does not guarantee proper data security conditions. This lack puts students at risk of graduation and undermines their trust in the University.
2. The lack of a foreign language component in this study program negatively affects the internationalization and its mobility opportunities.
3. Lack of more complete information on the official website of UAMD, and more specifically for the study program of the second cycle, Professional Master "Policy and Administration", with the profile "Public Administration".

4. There is a lack of suitable facilities for the development of study hours by students. The library hall, which also serves as a study hall, is insufficient for all UAMD students.

**c. Recommendations:**

1. It is recommended that UAMD provide as soon as possible the physical registers for keeping student records for the study program of the second cycle, Professional Master "Policy and Administration", with the profile "Public Administration".
2. It is recommended that the institution intensify its efforts towards providing the widest and most complete public information on the website. For the best possible progress of the study program and to ensure a harmony of the study program with the general public, it is necessary to enrich the official website.
3. It is recommended to add a foreign language as a component of the curriculum of this study program.
4. It is recommended to increase the autonomy of professors in the selection of student assessment methods.
5. Despite the fact that the Regulation of the Study Program stipulates that at the end of this study program the student must prepare a micro thesis, currently the chosen practice is that of conducting a final exam. Proper implementation of the regulation in question is recommended.
6. It is recommended to expand the library hall or adapt the dedicated premises as study halls, to make this facility more accessible for the student.



## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Niveli i përmbushjes	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X